



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.699/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Kymete Kicaj dhe Milena Deric anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesat e Basri Gashani, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Glllogocit, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN të palejuara ankesat Anr.699/2021, Anr.700/2021 dhe Anr.701/2021 të gjitha të datës 21.10.2021, të paraqitura nga Basri Gashani, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Glllogocit, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 21.10.2021 ka pranuar ankesat Anr.699/2021, Anr.700/2021 dhe Anr.701/2021 nga Basri Gashani, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Glllogocit, më të cilën theksohet se në vendvotimet 0302E-02R, 0309E dhe 0305E/01D ka pasur keqpërdorim të votave dhe i njëjti kërkon që kutit e votimit në këto vendvotime të hapen dhe të bëhet rinumërimi i tyre. Gjithashtu pretendon se në këto vendvotime ka pasur vota të familjarëve të tij të cilat nuk i kanë dalur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

Paneli, pasi ka vlerësuar pretendimet në ankesat Anr.699/2021, Anr.700/2021 dhe Anr.701/2021 të datës 21.10.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i ankesave është Basri Gashani, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllogocit dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesat e paraqitura përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ti hudhë si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hudhja e ankesave të Basri Gashani, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, në Komunën e Gllogocit nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.699/2021 më datën 22.10.2021

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

